

BULETIN Nr. 2
Shkurt 2019

INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 2

Integritet Llogaridhënie Partneritet

Shkurt 2019

Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Dalina Jashari, Kontribuese

Redion Qirjazi, Kontribues

Armela Xhaho, Kontribuese

Leonie Vrugtman, Kontribuese

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Elsa Toska, Eksperte Ligjore e Etikës dhe Integritetit

Erald Bezhani, Ekspert i Menaxhimit të Riskut Institucional

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241

NË VEND TË HYRJES 3

SHËNIME NGA TAKIMET
LLOGARIDHËNËSE 4

NË FOKUS

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE
LLOGARIDHËNËSE PËR
PARANDALIMIN E KRIMIT

Dropull: Ministri i Brendshëm
për herë të parë në bashki të
minoritetit grek 5

Shkodër: Këshilli bashkiak
miraton buxhetin për
kamerat e sigurisë në
ambjentet publike 7

Dibër: Nevojiten masa
konkrete dhe angazhim i
përbashkët për zgjidhjen e
problematikave 9

PLANI I INTEGRITETIT

Faza 2: Identifikimi dhe
analiza e riskut të integritetit 10

Lushnje: Bashkëveprimi ndër-
institucional thelbësor për të
forcuar normat dhe kulturën e
çdo qyteti 12

Kavajë: Takimet llogaridhënie
për krijimin e kulturës së
komunitetit dhe ballafaqimin
e punës së institucioneve me
realitetin 13

PRAKTIKA TË MIRA
NDËRKOMBËTARE

Qasja Administrative kundër
Krimin të Organizuar 14

Si funksionon Modeli i Aleancës
së Sigurisë në Rotterdam? 15

NË VEND TË HYRJES

I nderuar lexues!

Për herë të parë në Policinë e Shtetit po bëhen përpjekje për të pilotuar një plan integriteti. Është një nismë e re dhe jo e lehtë.

Plani i Integritetit është një hap konkret, për të vlerësuar dhe evidentuar angazhimet e Policisë ndaj shërbimeve cilësore për qytetarët, bazuar në parimet e drejtësisë, transparencës dhe paanësisë, si dhe për të forcuar legjitimitetin e veprimtarive policore, në drejtim të rritjes së sigurisë publike dhe garantimit të mbrojtjes të së drejtave të qytetarëve.

Përuojën nga puna në Komisaratin Nr. 1 ku pilotohet plani i integritetit, IDM është duke e ndarë me të gjithë lexuesit e interesuar përmes këtij buletini.

Përse është e rëndësishme një sipërmarrje e tillë:

- **Politikat institucionale mbi integritetin** janë thelbësore, sepse ato forcojnë kulturën dhe vlerat demokratike, forcojnë ligjshmërinë dhe shtetin e së drejtës. Plani Kombëtar i Veprimit i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër-Korrupsionit 2018-2020 parashikon hartimin dhe miratimin e planit të integritetit nga të gjitha institucionet publike. Një nga "detyrat e shtëpisë" të lëna për Shqipërinë nga Komisioni Evropian (2018), është zbatimi i Strategjisë Kundër-Korrupsionit, duke bërë referencë konkrete mungesën e një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.
- **Për formimin e një kulture administrative të brendshme në Policinë e Shtetit**, pro integritet, duhen ndërtuar politika të vazhdueshme dhe të qëndrueshme mbi integritetin, dinamika e të cilave, mund ta kthejnë Policinë e Shtetit në një institucion të hapur brenda vetes për debate, diskutime, kritika dhe rritje të standardeve profesionale dhe ligjore. Kjo do të forconte demokracinë brenda organizatës policore, një vlerë kjo e patjetërsueshme dhe dukshëm e munguar.
- Për të ndërtuar dhe përvetësuar standarde etike dhe profesionale të cilat do të **shfaqnin në publik** integritetin e organizatës dhe individit në raport me qytetarët duke siguruar komunikim dhe bashkëpunim më të mirë e për rrjedhojë një besueshmëri më të lartë publike.
- Integriteti nuk është vetëm çështje e nivelit personal, pra përgjegjësi e çdo punonjësi policie për sjelljen individuale, por mbi të gjitha **është çështje e institucionit**, çka do të thotë se organizata e Policisë së Shtetit përcakton procese, instrumente dhe strategji, që inkurajojnë dhe mbështesin sjellje dhe veprime me integritet të punonjësve dhe strukturave drejtuese dhe operacionale të saj. Integriteti institucional reflektohet në hartimin dhe zhvillimin e planit të integritetit si dokument masash dhe prioritetesh, që adreson trajtimin e risqeve të integritetit sipas problematikave përkatëse në Policinë e Shtetit dhe specifikave të çdo komisarati.
- **Plani i Integritetit** është një instrument i rëndësishëm që synon parandalimin e korrupsionit në radhët e Policisë. Plani i Integritetit përgatitet për të rritur ndërgjegjësimin mbi risqet e integritetit në veprimtarinë e organizatës policore dhe për të adresuar mundësinë e korrupsionit ose formave të tjera të parregullive apo paligjshmërive brenda institucionit. Plani nuk synon zgjidhjen e rasteve të veçanta të korrupsionit, por ndërtimin e mekanizmave dhe ndjekjen e rekomandimeve konkrete dhe një plani masash, të cilat pritet të eliminojnë rrethanat dhe të zvogëlojnë risqet e veprimeve jo-etike dhe jo-profesionale në fushën e veprimtarisë së Policisë së Shtetit.

IDM beson se pilotimi me sukses i Planit të Integritetit vjen si një risi me synim mirë-funksionimin e sistemit të menaxhimit të integritetit të organizatës policore. Si kundër, sukcesi i tij është lidhur me seriozitetin dhe investimin e drejtuesve dhe punonjësve të Komisarimit Nr. 1 ku po punohet.

Ekipi i IDM



SHËNIME NGA TAKIMET LLOGARIDHËNËSE

Nevojat për policimin në komunitet burojnë nga jashtë policisë, nga kërcënimet dhe nga domosdoshmëria për siguri të qytetarëve, nga sfida për të ndryshuar mentalitetin pasiv shoqëror për të raportuar krimin, nga niveli i hapjes dhe i bashkëpunimit të qytetarëve me policinë dhe institucioneve të zbatimit të ligjit.

Reagimi institucional i policisë si pjesë e detyrimit të saj ligjor për rend dhe siguri publike detyrimisht të çon drejt një filozofie policimi që mbështetet tek partneriteti, bashkëpunimi dhe besueshmëria e qytetarëve.

Modeli dhe eksperiencat nga takimet llogaridhëse janë mundësi reale që drejtuesit vendorë të policisë, bashkisë, apo prokurorisë veçmas dhe së bashku të ngrenë një punë parandaluese, proaktive dhe afatgjatë.

Disa nga shembujt e mëposhtëm ilustrojnë nevojën për një qasje të tillë parandaluese: në Peshkopë nga anëtarë të këshillit bashkiak dhe përfaqësues të shoqërisë civile pyetet nëse ka një plan veprimi nga policia për tu përballur me problematikën. Në Shkodër u ra dakord të vazhdohej takime midis institucioneve përdorimin e lëndëve narkotike në shkolla.

Në bashkinë Dropull, përfaqësues të komunitetit jo vetëm mbështetën takimet llogaridhëse të tre institucioneve, por shprehën se realizimi periodik i tyre, shmang tensionet e ndryshme.

Ministri i Brendshëm z. Sandër Lleshaj pati një komunikim pozitiv me përfaqësuesit e komunitetit dhe këshillin bashkiak në Dropull. Pas dy javësh Ministri Lleshaj zhvilloi gjithashtu një takim edhe me autoritetet vendore në bashkinë e Shkodrës dhe Malësinë e Madhe.

Ndërsa, në takimin llogaridhës në Selenicë ishin përfaqësues të komunitetit, apo kryetarë fshattrash që sollën problematika mjaft sensitive për rendin, të cilat e vendosin policinë në pozita pune.

Për më tej, përfaqësuesit e prokurorisë kanë qenë jo vetëm tërësisht mbështetës, por secili prej prokurorëve është shprehur i angazhuar për të avancuar më tej këtë praktikë në mënyrë periodike.

Në fakt, pesha kryesore e këtyre ballafaqimeve publike për shkak të natyrës së problemeve duhet të bjerë mbi qeverisjen vendore. Editoriali i buletinit të ardhshëm do të trajtojë në mënyrë më shteruese peshën që duhet të mbajë qeverisja vendore dhe pse pa një bashkëpunim funksional me bashkinë nuk mund të ketë një policim në komunitet real dhe efektiv.

SERIA E TAKIMEVE PUBLIKE LLOGARIDHËNËSE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

NË DIALOG TË HAPUR ME GRUPET E INTERESIT DHE
KOMUNITETIN

DROPULL: MINISTRI I BRENDSHËM PËR HERË TË PARË NË BASHKI TË MINORITETIT GREK

Me anë të takimeve llogaridhënese për rendin dhe sigurinë publike të organizuar nga IDM, për herë të parë një Ministër i Brendshëm viziton Dropullin. Gjithashtu, në këtë takim të hapur me komunitetin dhe grupet e interesit morën pjesë drejtues të Policisë Vendore Gjirokastrë, drejtues të Prokurorisë, Prefekti i Qarkut dhe zv.ambasadorja e Holandës në Tiranë.

Banorët e vlerësuan nismën si një platformë të mirë komunikimi dhe për rreth 2 orë i drejtuan pyetje panelit si dhe ngritën shqetësime që hasin në jetën e përditshme si: shkëputja e energjisë elektrike, infrastruktura rrugore e papërshtatshme për zonat e thella, bastisja e shtëpive si dhe mungesa e punësimit. Bashkia e Dropullit, e banuar kryesisht nga minoriteti grek, ka në përbërje 41 fshatra dhe ka një nivel kriminaliteti ndër më të ultit në qark.

Në fjalën e tij, kryetari i bashkisë z. Arqile Deçka solli në vëmendje nevojën për të rritur mundësitë për punësim të të rinjve si dhe rritjen e investimeve, pasi në kushtet aktuale të rinjtë priren të emigrojnë, duke bërë që e gjithë zona të zbrazet nga të rinjtë.

Ndërsa Drejtori i Policisë Vendore Gjirokastrë, z. Perlat Vatoci u shpreh se komuniteti i kësaj zone është i prirur për të zbatuar ligjet e vendit, megjithatë

ai renditi disa ndër fenomenet më shqetësuese në këtë zonë si: vjedhjet, shpërdorimi i tokës dhe prerja e pyjeve, dhuna në familje dhe kultivimi i lëndëve narkotike. Gjithashtu ai theksoi nevojën për përmirësimin e policimit në komunitet.

Zv.ambasadorja e Holandës në Tiranë znj. Petra Heylen përmendi një mekanizëm të ngjashëm në Holandë, atë të “trekëndëshit polici-prokurori-qeverisje vendore” që i shërben me efikasitet publikut. Në këtë drejtim, “përmirësimi i integritetit të policisë nuk është vetëm një kriter për aderimin në Bashkimin Evropian, por është indikator i mirëqeverisjes së publikut”, u shpreh znj. Heylen. Më tej, ajo shtoi se llogaridhënia nuk është një temë e thjeshtë, prandaj është thelbësore të bëhet në mënyrë transparente dhe me dialog të hapur.





Më tej drejtuesi i Prokurorisë së rrethit Gjirokastrë vuri theksin tek ajo që quhet ‘pushtimi i tokës’ në këtë zonë dhe bëri thirrje që për këtë problematikë qytetarët t’i drejtohen më së pari zyrave të pushtetit vendor. Përveç kësaj dhe në përgjigje të pyetjeve të banorëve për rastin e ngjarjes së Bularatit, prokurori sqaroi rrethanat dhe veprimet e institucioneve përkatëse për çështjen e cila është ende nën hetimin e prokurorisë.

Në fjalën e tij, ministri Lleshaj nënvizoi se “ne duhet që Policinë ta konsiderojmë si Policinë tonë. Dhe ka shumë mënyra për t’u afruar me të. Së pari, duhet që vetë policia ta fitojë besimin e qytetarëve, duhet që ajo ta bëjë hapin e parë. Por, duhet që edhe qytetarët të mundohen të gjejnë tek policia një partner të tyre. Unë besoj se rruga më e mirë për ta bërë këtë dhe, këtu gjej rastin për ta përsëritur këtë thirrje, është që ne duhet t’i shohim djemtë dhe vajzat e minoritetit grek pjesë të Policisë tonë. Do të ishte një investim i madh për Policinë e Shtetit tonë, por dhe për miqësinë tonë, edhe për marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe grekëve, që pjesëtarë të minoritetit etnik grek të bëhen pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit tonë”. Gjithashtu, ministri vuri në dukje se

duhet një vëmendje më e lartë nga ana e institucioneve vendore për minoritetin si dhe u angazhua në afrimin e policisë tek komuniteti, në mënyrë që ajo të jetë më afër qytetarëve.

Në përfundim të takimit, z. Sotiraq Hroni, drejtor ekzekutiv i IDM u shpreh se: “duhet të rritet niveli i kontaktit, komunikimit ndërmjet aktorëve vendorë dhe rrjedhimisht do të rritet niveli i besueshmërisë në komunitet.

Përfaqësues të komunitetit jo vetëm mbështetën takimet llogaridhënëse të tre institucioneve, por shprehën se realizimi periodik i tyre, shmang tensionet e ndryshme

SHKODËR: KËSHILLI BASHKIAK MIRATON BUXHETIN PËR KAMERAT E SIGURISË NË AMBJENTET PUBLIK

Në takim në Shkodër, grupet e interesit, përfaqësuesit e institucioneve vendore u angazhuan në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë për zgjidhjen e problematikave të evidentuara.

Znj. Voltana Ademi, kryetarja e Bashkisë, nënvizoi se secili institucion, përfshi edhe komunitetin, duhet ta shohë veten pjesë të këtij kontributi duke evidentuar problematikën në garantimin e sigurisë publike. Në këtë kontekst, znj. Ademi bëri thirrje që “t’i jepet një vlerë lokale asaj që duam të përmirësojmë dhe të adresohen problematikën tek institucionet përkatëse”.

“Ne e kemi parë këtë takim si një mundësi të mirë të diskutimit për të bashkëpunuar lidhur me problematikën që ka dhe që kemi që nuk lidhen vetëm me krimin e organizuar që është një ekstrem dhe është një problem i rëndë me të cilin policia është përballur. Por po bëjmë fjalë edhe për çështje të tjera që lidhen me sigurinë, nga ato më të voglat duke vazhduar edhe me konfliktet që mund të lindin në komunitetet tona”. Voltana Ademi, Kryetare e bashkisë Shkodër



Në përgjigje të problematikave të ngritura nga përfaqësuesit të institucioneve arsimore për sigurinë në shkollë, znj. Ademi u zotua dhe bëri të mundur që në buxhetin bashkiak për vitin 2019 të parashikohej investimi për vendosjen e kamerave të sigurisë në ambientet dhe institucionet publike me një fond prej 6,663 milionë ALL dhe vijimi i investimeve për përmirësimin e sinjalistikës rrugore.

Gjithashtu, u dakordësua për një koordinim më të mirë të policisë së shtetit dhe policisë bashkiake për të qenë të pranishëm në oraret e nevojshme për shkollat. Ndërsa për shqetësimin e shpërndarjes së lëndëve narkotike në afërsi të shkollave, znj. Ademi u angazhua për hartimin e një plani masash bashkarisht me institucionet përkatëse të arsimit për ta trajtuar këtë problematikë.

Më tej, z. Vehbi Bushati, drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, e cilësoi si të domosdoshëm takimin për llogaridhënien e policisë ndaj të gjithë aktorëve vendorë, edhe për shkak se policia ka një aktivitet të larmishëm që jo gjithmonë është i dukshëm për qytetarët. “Pas një sërë ngjarjesh kriminale nga fillimi i vitit, angazhimi i policisë ka qenë maksimal për zgjidhjen e këtyre rasteve; hetimet vazhdojnë dhe reagimi ka qenë në nivelin më të lartë”, është shprehur z. Bushati.

Ai renditi gjithashtu dhe 3 shtyllat kryesore të punës së policisë:

1. Integriteti individual
2. Integriteti profesional
3. Paanshmëria në kryerjen e detyrave

Lidhur me këtë, z. Bushati theksoi se vitin e fundit ka pasur një rritje të zbulueshmërisë së veprave penale, por kërkohet profesionalizëm në trajtimin e



tyre. “Garantimi i sigurisë dhe rendit bëhet atëherë kur qytetarët bëhen aksionerë me ne duke zbatuar ligjin dhe duke raportuar shkeljet”, tha ai.

Z. Bushati renditi disa nga veprimtaritë në fokus të policisë si: puna në shkolla, veçanërisht për identifikimin e rasteve të shpërndarjes së lëndëve narkotike në afërsi të shkollave. Ai theksoi se prindërit dhe drejtuesit e shkollave duhet të jenë më aktivë në raportimin e këtyre rasteve.

Policia është e angazhuar gjithashtu me emergjencat civile (në zonat e përmbytura), garantimin e një sezoni turistik pa incidente, në sigurinë rrugore dhe lirinë e hapësirave publike në bashkëpunim me bashkinë. Prioritet vijon të jetë zbulimi i kultivuesve të lëndëve narkotike dhe lufta ndaj krimit të organizuar.

Në fund, z. Bushati theksoi se në mënyrë që organizata e policisë të përmirësohet duhet që qytetarët të raportojnë rastet e policëve të korruptuar. Në këtë drejtim, policia po reformohet përmes krijimit të zonave policore që qytetarët të marrin shërbimin më afër qendrës së banimit në çdo njësi administrative.

Përfaqësuesit e njësive administrative kërkuar nga përfaqësuesi i policisë një patrullim më të shpeshtë në zonat e thella, sidomos gjatë natës, për shkak të problemit të vjedhjeve të banesave.

Ndërsa përfaqësues të medias sollën në vëmendje riaktivizimin e ngjarjeve kriminale në Shkodër dhe kërkuar nga

përfaqësuesit e policisë e prokurorisë të dhëna mbi masat e marra nga këto institucione. Në përgjigje të këtij konstatimi, z. Bushati u shpreh se “punohet çdo ditë për të identifikuar shkelësit e ligjit dhe kriminelët. Ne po vuajmë nga sa pak denoncohet kriminaliteti dhe paligjshmëria, dhe në këtë aspekt, media mund të ndihmojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për të raportuar”.

Gjithashtu znj. Arjola Prençi, prokurore e rrethit Shkodër, bëri thirrje për më shumë bashkëpunim nga ana e qytetarëve dhe institucioneve. “Zyrat e prokurorisë janë të hapura për qytetarët, koha e të fortëve ka marrë fund”, u shpreh znj. Prençi.

Një rol aktiv në diskutimet e zhvilluara në takimin llogaridhënës në Shkodër kishin kryetari i Këshillit Bashkiak si dhe përfaqësues të njësive administrative dhe zyrës së Drejtorisë Arsimore Shkodër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Xhemal Bushati nënvizoi se mbetet problem indiferentizmi i qytetarëve për vendimmarrjen vendore. Sipas tij, qytetarët denoncojnë kur kanë besim se do të ruhet anonimat i raportimit. Gjithashtu, policia e shtetit dhe policia bashkiake duhet të bashkëpunojnë më njëri-tjetrin dhe jo të ndërhyjnë në kompetenca.

DIBËR: NEVOJITEN MASA KONKRETE DHE ANGAZHIM I PËRBASHKËT PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMATIKAVE

Takimi Publik Llogaridhënës për Parandalimin e Krimit në Peshkopi mbledhi së bashku përfaqësuesit e institucioneve vendore z. Muharrem Rama, Kryetarin e Bashkisë Dibër, z. Edmond Tarkaj, drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, si dhe z. Rifat Kojku, përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit në një komunikim të hapur me përfaqësuesit e njësive administrative dhe fshatrave, përfaqësues të institucioneve arsimore, bordet e prindërve, qeverive të nxënësve, përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të ndryshme të interesit.

Në fjalën e tij z. Muharrem Rama vuri në dukje gatishmërinë e bashkisë për të bashkëpunuar me aktorët e tjerë për përmirësimin e sigurisë publike si dhe ftoi komunitetin të raportojë shqetësimet pranë institucioneve përkatëse.

Ndërsa z. Edmond Tarkaj parashtroi situatën e kriminalitetit në bashkinë Dibër dhe krijimin e zonave policore për të mbuluar të gjithë territorin e bashkisë. Ai cilësoi si arritje garantimin e një sezoni të qetë turistik dhe mungesën e rasteve të kultivimit të bimëve narkotike. Problematike për vitin e kaluar kanë qenë vrasjet për konflikte pronësie, mosrespektimi i kodit të qarkullimit rrugor, ndërtime pa leje dhe vjedhje banesash dhe bagëtish. Z. Tarkaj shtoi se ka një prani të shtuar të policisë në shkollë, por vijon të mbetet problem përdorimi i kanabisit duke kërkuar kështu një bashkëpunim më të mirë mësues-prindër-polici.

Përfaqësuesi i Prokurorisë së Rrethit, z. Rifat Kojku vlerësoi se bashkia Peshkopi ka një tendencë në rënie të kriminalitetit. Megjithatë, institucioni i prokurorisë konsideron si problematike vjedhjet e banesave dhe ndërtime pa leje. Z. Kojku nënvizoi rolin e bashkisë dhe policisë në referimin e rasteve pranë prokurorisë si dhe kërkoj që nga ana e policisë të realizohet një evidentim më i saktë i problematikës në vend-ngjarje. Gjithashtu përfaqësuesi

i prokurorisë u shpreh i gatshëm për të zhvilluar takime periodike me qytetarët.

Pjesëmarrësit e këtij takimi llogaridhënës ishin shumë aktivë në ngritjen e çështjeve problematike të zonës. Të rinjtë e pranishëm veçuan përhapjen e lojërave të fatit dhe përdorimin e lëndëve narkotike si problematika më urgjente. Drejtues të arsimit vunë në dukje pasigurinë e fëmijëve nga qentë e rrugës jo vetëm në qytet, por edhe zona të tjera rurale.

Gjithashtu, një anëtar i këshillit bashkiak kërkoj nga policia dhe prokuroria informimin e publikut për masat konkrete ndaj këtyre shqetësimeve dhe pyeti nëse ekziston një plan konkret për adresimin e problematikës nga çdo institucion.

Në tërësi, pjesëmarrësit theksuan nevojën për rritjen e transparencës për përdorimin e fondeve publike, masa për uljen e papunësisë si dhe nevojën për një bashkëpunim më të madh ndërmjet institucioneve.

“Pavarësisht arritjeve që prezantohen, shohim që shumë probleme mbeten të mprehta dhe me ndikim negativ në jetët e njerëzve, sidomos fëmijëve dhe të rinjve si: dhuna, përdorimi i substancave narkotike, etj. Kjo do të thotë që ka gjëra që nuk janë zgjidhur siç duhet, ndaj ulja së bashku, diskutimi i problematikave, gjetja e zgjidhjeve dhe angazhimi i përbashkët, duhet të bëhet një praktikë pune e vazhdueshme e të gjitha institucioneve”

Majlina Hoxha, Aktiviste e shoqërisë civile-pjesëmarrëse në takim





PLANI I INTEGRITETIT

Në numrin e parë të këtij buletini u prezantuan në tërësi elementët dhe faza e parë përgatitore për hartimin e Planit të Integritetit (PI) për komisariatit Nr. 1 në Tiranë. Në këtë numër do të paraqesim komponentët e fazës së dytë.

FAZA 2: IDENTIFIKIMI DHE ANALIZA E RISKUT TË INTEGRITETIT

Komisariati, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përballet me risqe korrupsioni dhe integriteti të cilat mund të kenë pasoja negative në përmbushjen e objektivave të synuara për institucionin. Nëpërmjet procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, komisariati mund të adresojë në mënyrë metodike dhe periodike risqet që çenojnë integritetin e institucionit në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij. Qëllimi i procesit është forcimi institucional ndaj korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të integritetit, eficensa dhe transparencja e veprimtarisë së organizatës policore, si dhe rritje e besueshmërisë publike.

Grupi i punës për integritetin (GPI), i komisariatit nr.1, po vijon procesin e vlerësimit të riskut të integritetit me fazën e dytë: identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit.

GPI ka nisur me identifikimin e objektivave strategjike, programore dhe operacionale të komisariatit, të ndara sipas seksioneve përbërëse të tij:

- i) krimet 1&2;
- ii) policimi në komunitet;
- iii) patrulla e përgjithshme;
- iv) siguria dhe ruajtja e objekteve.

Pas vendosjes së objektivave, procesi po vijon me identifikimin e risqeve ndaj integritetit i cili përfshin gjetjen dhe

përshkrimin e risqeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave. Në identifikimin e tyre GPI i referohet përvojës së mëparshme të institucionit që gjendet në raporte/analiza ndryshme të brendshme të komisariatit, si edhe të ardhmes që lidhet me ndryshimet e pritshme ligjore, politike, ekonomike, sociale etj.

Risqet e identifikuara mund të jenë të jashtme ose të brendshme. Risqet e jashtme lidhen me mjedisin jashtë komisariatit, si: risqe të nivelit makro (ekonomik, forcë madhore); vendimet politike, ambjenti social dhe teknologjik, partnerët e jashtëm (agjencitë e ndryshme, media, biznesi etj).

Risqet e brendshme rrjedhin nga veprimtaria e komisariatit dhe përfshijnë:

- i) risqe të lidhura me aspektet e ligjshmërisë dhe mbikëqyrjes, të cilat mund të përkrijnë me mungesën e qartësisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë të rregullave/procedurave standarde të miratuara mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë së komisariatit;
- ii) risqe që lidhen me burime njerëzore si dhe me vetë institucionin si p.sh: etika dhe sjellja në institucion, burimet njerëzore të vëna në dispozicion të seksioneve, organizimi i brendshëm, personeli i sigurisë etj;
- iii) risqe që lidhen me informimin dhe komunikimin: metodat dhe kanalet e komunikimit, informacion i cilësisë së lartë dhe në kohë;
- iv) risqe që lidhen me planifikimin, proceset dhe operacionet e komisariatit të tilla si: procese operacionale, procese financiare, sistemi i IT dhe sisteme të tjera mbështetëse.

GPI gjithashtu po identifikon dhe vlerëson

masat ekzistuese për menaxhimin e riskut në nivel komisarati, për të përcaktuar nëse ato janë zbatuar dhe nëse është arritur efekti i pritur nga zbatimi i tyre.

Risqet e identifikuar, faktorët e tyre, mundësia e ndodhjes së tyre dhe impakti/ndikimi që ato kanë në integritetin e komisaritit, si dhe mënyra e trajtimit të tyre, janë në proces diskutimi nga GPI me punonjësit e seksioneve të komisaritit.

Gjatë gjithë kësaj faze GPI po i kushton vëmendje të veçantë kuadrit ligjor dhe rregullator për veprimtarinë e policisë së shtetit dhe konkretisht të veprimtarisë së komisaritit mbi parandalimin e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit, sjelljes jo-etike, jo-profesionale dhe parregullsive të tjera që mund të shfaqen gjatë veprimtarisë së komisaritit.

Tabela përmbledhëse e fazave që do të trajtohen në numrat e ardhshëm Planit të Integritetit për komisaratin nr.1, Tiranë:

Faza 3: Vlerësimi i risqeve ndaj integritetit	
1	Vlerësimi i intensitetit të risqeve të identifikuar dhe ndërveprimi i mundshëm i tyre.
2	Renditja e risqeve të identifikuar sipas përparësisë (sipas rezultateve nga matrica e riskut).
3	Hartimi i raportit të vlerësimit të risqeve.
Faza 4: Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut dhe Regjistri i Riskut	
1	- Hartimi i Regjistrit të Riskut (përshkrim të detajuar i të gjithë risqeve të identifikuar). - Hartim i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Risqeve i cili përfshin: masat për trajtimin e risqeve dhe aktivitetet e kontrollit; efektet financiare të nevojshme për zbatimin e masave (nëse ka); rekomandime për përmirësimin e aktiviteteve në kuadër të fushave të veprimtarisë së komisaritit; si dhe rregulla mbi zbatimin e masave për kontrollin e risqeve të identifikuar.
2	Përgatitja e raportit përfundimtar për gjendjen e integritetit në komisarit.
3	Hartimi i Planit të Integritetit (konsolidim i të gjithë dokumenteve të prodhuara në kuadër të procesit të VRI: plani i veprimit të menaxhimit të risqeve, regjistri i riskut dhe raporti përfundimtar i integritetit) dhe dorëzimi i tij para shefit të komisaritit.
4	Prezantimi i Planit të Integritetit për të gjithë punonjësit e komisaritit, publikun dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces.
5	Miratimi i Planit të Integritetit.
Faza 5: Monitorimi dhe Raportimi	
1	Ngritja e një sistemi monitorues të bazuar në evidencë mbi progresin e zhvillimit të integritetit.
2	Emërimi i koordinatorit të integritetit (një punonjësi përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e planit të integritetit në komisarit).
3	Informim periodik për shefin e komisaritit dhe seksionet përkatëse të tij, mbi zbatimin e planit të integritetit.
4	Hartimi dhe vënia në funksion i instrumenteve të komunikimit ndërmjet koordinatorit të integritetit, shefit të komisaritit dhe administratës përkatëse.

LUSHNJË: BASHKËVEPRIMI NDËR-INSTITUCIONAL THELBËSOR PËR TË NGRITUR NORMAT DHE KULTURËN E ÇDO QYTETI



Takimi llogaridhënës në bashkinë e Lushnjës mbledhi së bashku kryetarin e bashkisë z. Fatos Tushe, shefin e komisariatit të policisë, z. Elton Papa, prokurorin z. Artan Hazbiu, kryetarë të fshatrave dhe njësisë administrative, nxënës, staf mësimor dhe prindër të shkollave të mesme të qytetit si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fjalën e tij hapëse, z. Tushe theksoi se siguria e rendi publik, zbatimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve janë çështje jo vetëm e Policisë së Shtetit por edhe e institucionit të qeverisjes vendore. Ndër të tjera, z. Tushe vuri theksin tek roli i administratorëve, të cilët duhet të sigurojnë komunikim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me qytetarët dhe me policinë në terren, si një element i rëndësishëm për të rritur besimin tek qytetarët dhe për të rritur nivelin e sigurisë publike vendore.

Pavarësisht se komunikimi i institucionit të bashkisë me Policinë e Shtetit vitet e fundit ka ardhur duke u intensifikuar në lidhje me menaxhimin e konflikteve në çështjet kundër dhunës në familje, shefi i komisariatit të Lushnjës theksoi se ende ka çështje për të patur shumë vëmendje siç janë krimi kundër pasurisë apo dhe vjedhjet e banesave.

Përtej bashkëpunimit ndër-institucional, prokurori i pranishëm në takim dhe shefi i komisariatit vunë theksin tek roli i angazhimit të qytetarëve në parandalimin e krimit dhe të situatave të tjera që çënojnë sigurinë publike. Prokurori Hazbiu vlerësoi praninë e institucionit të prokurorisë në këtë takim si një mundësi për të komunikuar me qytetarët e Lushnjës, duke u dhënë mesazhin se *“për të goditur krimin, duhet bashkëpunim mes qytetarëve, përfshirë dhe të akuzuarit. Komuniteti në këtë bashki është apatik dhe institucioni i prokurorisë has vështirësi në lidhje me mungesën e denoncimeve të rasteve, të dhënies së dëshmimeve nga ana e qytetarëve, madje edhe për çështje të cilat janë shumë të ndjeshme dhe që përbëjnë kërcënim serioz për sigurinë vendore”*.

Në të njëjtin diskutim, banor i një fshati në Lushnjë thekson se qytetarët dhe institucionet e sigurisë duhet të kenë vëmendje dhe në rastet e sherreve të cilat konsiderohen fillimisht banale, por që më tej shndërrohen në vepra penale, siç janë të shumta rastet në këtë bashki mbi çështje të pronësisë. Në këtë kontekst, duhet të jenë dhe vetë banorët të ndërgjegjësuar që të denoncojnë çdo rast mosmarrëveshjeje, duke parandaluar kështu çdo lloj krimi të mundshëm.



KAVAJË: TAKIMET LLOGARIDHËNËSE PËR BALLAFAQIMIN E PUNËS SË INSTITUCIONEVE ME REALITETIN

Shefi i Policimit në Komunitet, z. Faik Ruko e vlerësoi takimin si një nismë të mirë për llogaridhënien e institucioneve vendore. Puna e Policisë për vitin 2018 ka qenë pozitive në bashkëpunim me prokurorinë dhe bashkinë. Në veçanti ka pasur një bashkëpunim të mirë në kuadër të strategjisë kundër kultivimit të bimëve narkotike. Fokusi i punës së komisarariatit të policisë Kavajë mbetet parandalimi dhe goditja e kriminalitetit, ku përgjatë vitit 2018 është rritur zbulueshmëria dhe janë regjistruar më pak vepra penale në këtë bashki.

Prokurori Artan Madani theksoi se takime të tilla krijojnë afërsi më të madhe me qytetarët për trajtimin e problematikave të komunitetit. Dy aspekte thelbësore të veprimtarisë së institucioneve vendore në raport me qytetarët janë:

- Institucionalizimi i një kulture llogaridhënieje, e drejtpërdrejtë, jo vetëm në formën shkresore ligjore, por dhe të përgjegjësisë komunitare. Kjo arrihet duke organizuar periodikisht këto forma takimesh, duke e formalizuar dhe nëpërmjet një marrëveshje mirëkuptimi ose bashkëpunimi;
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve që të ndjekin problemet e tyre në formë zyrtare sipas procedurave në institucionet përkatëse.

Në fjalën e tij, kryetari i bashkisë, z. Isa Sakja nënvizoi faktin se Kavaja ka shkallën më të ulët të kriminalitetit në vend, gjë që është meritë e komunitetit gjithashtu. Bashkia ka marrë të gjitha masat për garantimin e sigurisë në bashkëpunim me institucionet e tjera. Në këtë kuadër janë marrë masat e duhura për përmirësimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale. Megjithatë, ai theksoi se nevojitet një angazhim më aktiv i

kryepoleqve në nxjerrjen e problematikave në zonat përkatëse.

Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit theksuan nevojën që policia të jetë më prezente përmes patrullimeve më të shpeshta në zonat e thella rurale, pasi janë shtuar vjedhjet në banesa. Përfaqësues të zyrës arsimore ngritën shqetësimin e sigurisë në shkolla dhe në afërsi të shkollave dhe nevojës për të zhvilluar takime më të shpeshta të punonjësve të policisë, kryesisht me nxënësit e shkollave të mesme.



“Takimi i zhvilluar në qytetin e Kavajës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Institucioneve Bashki-Prokurori-Polici, mendoj se krijoi një realitet konkret, për idetë dhe mesazhet që u trajtuan.

Në një periudhë të ngarkuar, siç është realiteti që po kalon shoqëria shqiptare, takime të tilla të thjeshta, të drejtpërdrejta, të prekshme me pjesëmarrësit në auditorë jo zyrtare, marrin kuptim konkret.

Përfaqësuesit vendorë duhet të kenë integritetin për tu përballur me realitetin, duhet të ndejnë përgjegjësinë e llogaridhënies dhe në të tilla rrethana, si dhe të krijojnë klimën e një bashkëpunimi në përputhje me kërkesat e realitetit ku jetojnë dhe punojnë.”

Artan Madani, Prokuror



PRAKTIKA TË MIRA NDËRKOMBËTARE

QASJA ADMINISTRATIVE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Krimi i organizuar rëndom është trajtuar si një nga fenomenet më problematike të shoqërisë sonë. Për më tepër, ajo që e bën më shqetësues fenomenin janë dyshimet për lidhje të mundshme të strukturave kriminale me drejtues politikë apo institucionale të vendit. Kuptueshëm, një gjë e tillë ka shkaktuar jo pak debate dhe pakënaqësi.

Sigurisht, kjo situatë tingëllon alarmante, por përvoja e deritanishme e vendeve që janë përballur me këtë fenomen ka dëshmuar se, në realitet, aktivitetet e krimit të organizuar jo vetëm zhvillohen në mjedisin e zakonshëm institucional, por shpeshherë ky mjedis është thelbësor për zhvillimin e tyre. Sipas studiuesve Siegel dhe Nelen, krimi i organizuar ka një marrëdhënie pothuajse simbiotike me institucionet e ligjshme në kurriz të së cilëve ai lulëzon. Si rrjedhojë duhet kuptuar se gjithmonë e më shumë aktivitetet e krimit të organizuar po ligjërohen përmes pamundësisë së institucioneve për ta parandaluar këtë gjë.

Pra, sa më jo-efiçentë të jenë institucionet e një shteti, aq më shumë hapësira shfrytëzimi nga organizata kriminale krijohen. Rrjedhimisht është e rëndësishme që institucionet t'i mohojnë krimit të organizuar një platforma nga të cilat mund të organizohen shkelje të tjera. Një praktikë e tillë institucionale njihet si qasje administrative dhe përkufizohet si “parandalimi i lehtësirave për aktivitete kriminale duke u mohuar kriminelëve mundësinë për të shfrytëzuar infrastrukturën ligjore-administrative, si dhe ndërhyrja e koordinuar për të shpërqëndruar dhe shtypur krimit e

organizuar dhe problemet e rendit publik.”

Pa dyshim që masat administrative nuk mund të veprojnë të vetme. Një përpjekje efektive kërkon bashkërendim midis gjyqësorit, strukturave ligj-zbatuese dhe masave administrative. Në tërësi, strategjia për të luftuar krimit e organizuar duhet të synojë jo vetëm (a) shpërqëndrimin dhe (b) shtypjen e krimit të organizuar por edhe (c) parandalimin e aktiviteteve të mundshme duke (1) identifikuar, (2) devijuar dhe (3) zbrapsuar veprimtaritë e mundshme kriminale. Një unitet i tillë qëllimi do të kufizonte aftësinë e organizatave të krimit të organizuar të zgjeroheshin dhe të zhvillonin aktivitetin e tyre në kurriz të strukturës ligjore-administrative të shtetit.

Në Shqipëri, lufta kundër krimit të organizuar ka pasur historikisht një qasje prapavepruese, me fokus primar shtypjen dhe ndërshkimin e veprimtarisë kriminale. Kjo qasje është vënë në lëvizje në veçanti përmes organeve ligj-zbatuese dhe atyre të drejtësisë kriminale, por në ditët e sotme lind nevoja për një bashkërendim më të madh. Për rrjedhojë, qasja administrative në luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri ka nevojë të vendosë si qëllim të saj in edhe forcimin e qëndrueshmërisë së institucioneve, dhe kjo nismë ka si bazë vlerësimin e praktikave ligjore, rregullative dhe proceduriale të institucioneve për të zhvilluar një analizë sa më të detajuar të riskut që do të ndihmonte në përcaktimin e metodave më efektive për të reaguar ndaj tij.

SI FUNKSIONON MODELI I ALEANCËS SË SIGURISË NË ROTERDAM?

Në numrin e parë të këtij buletini është bërë një përshkrim i përgjithshëm mbi Aleancën e Sigurisë së Roterdamit, ku bashkitë, policia dhe zyra vendore e prokurorisë punojnë së bashku në kuadër të një aleance për sigurinë e rajonit. Kjo Aleancë është krijuar si një platformë e cila zhvillon takime ndërmjet institucioneve të ndryshme vendore dhe çdo 6 muaj publikon një përmbledhje të situatës së krimit në këtë rajon.

Kjo Aleancë është e domosdoshme, jo vetëm sepse Roterdami është ndër qytetet më të mëdha të Holandës, por gjithashtu është porti më i madh detar në Evropë. Në 2017, porti ka menaxhuar 467.4 milion ton ngarkesash detare, ngarkesë e cila është dyfish më madhe se ajo portit të dytë më të madh në Evropë Antwerp. Krahas menaxhimit të ngarkesave të konsiderueshme me mallra, gjë që është në vetvete sfiduese për mirëqenien e rajonit, Roterdami është një destinacion i njohur për trafikun e jashtëligjshëm. Sipas Europol, gjysma e sasisë së kokainës në Evropë kalon nëpërmjet portit të Roterdamit. Porti gjithashtu përdoret për të eksportuar XTC (ekstazi) e cila prodhohet në Holandë dhe shpërndahet përtej kufijve.

Këto lloj veprimtarish nuk çenojnë vetëm portin, por edhe të gjithë shoqërinë. Në 2017, numri i vdekjeve prej drogës është dyfishuar në krahasim me vitin 2016. Situata ka qenë aq e rëndë sa Policia Holandeze bëri një deklaratë mbi shqetësimin e saj se Holanda po kthehej në një narko-shtet. Për të trajtuar këtë rast dhe çështje të tjera lidhur me sigurinë nevojitet mbështetja dhe bashkëpunimi i të gjithë organeve të qeverisjes.

Statistikat e fundit të Aleancës së Sigurisë së Roterdamit tregojnë se krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, numri i krimeve në gjysmën e parë të vitit 2018 ka rënë me 14 për qind. Më konkretisht, ka pasur rënie në vjedhjet e shtëpive (-21%), plaçkitjet (-11%), vjedhjet e automjeteve

(-10%), hajdutët e xhepave (-42%), etj. Gjithashtu institucionet e Aleancës së Sigurisë së Roterdamit kanë një pamje gjithnjë e më të qartë për situatën e krimit në rajon, siç janë vepra penale e mashtrimit, pastrimi i parave dhe veprat kriminale të lidhura me drogën. Këto institucione po punojnë për forcimin e një qasjeje të integruar kundër krimit të organizuar.

Partneriteti tripalësh në nivel rajonal ose vendor

Partneriteti ndërmjet policisë, prokurorisë dhe qeverisë nuk është veçanti vetëm për Roterdamin: të gjitha rajonet në Holandë kanë një sistem të ashtuquajtur “Trekëndëshi Rajonal”. Trekëndëshi shërben si një organ këshillimor midis përfaqësuesve të policisë, zyrës së prokurorisë dhe qeverive lokale, gjë e cila ndihmon në shpërndarjen më të thjeshtë të informacionit dhe në adresimin e problemeve në një kohë më të shkurtër. Megjithatë arsyeja kryesore e ekzistencës të këtij trekëndëshi është për të treguar se institucionet janë të ndërlidhura dhe u nevojitet ndihma e njëri-tjetrit për të pasur një performancë më të mirë në kryerjen e detyrës.

Çdo institucion ka juridiksionin e tij dhe nuk mund të funksionojë pa ndihmën e institucioneve të tjera. Prokurori është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe ndjekjen penale të atyre që e shkelin atë. Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në vend. Të dyja palëve u nevojitet policia për të përmbushur detyrat e tyre. Një prokuror nuk mund të ndjekë penalisht një të akuzuar nëse policia nuk e ka hetuar më parë çështjen. Po ashtu dhe Kryetari i Bashkisë nuk mund të ruajë rendin dhe sigurinë në vend pa ndihmën e policisë. Bashkëpunimi është një faktor pozitiv për të rritur llogaridhënien në komunitet dhe për të adresuar sa më mirë çështjet e sigurisë.

POLICI

BASHKI

PROKURORORI

INTEGRITET



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands